



Datë: 21.05.2025
Numër Protokolli: 3384/2025

A.nr.455/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtar, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.455/2025, të datës 12.03.2025, të parashtruar nga ankuesi A.Th, kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.05.2025 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës numër A.nr.455/2025, e datës 12.03.2025, e parashtruar nga ankuesi A.Th.

A r s y e t i m

Ankuesi A.Th(me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 12.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr. 455/2025, kundër njoftimit të datës 24.02.2025, për përzgjedhjen përfundimtarë të kandidatit të suksesshëm për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Cilësinë e Inspektimeve dhe Standardizimin e Gjobave”, me pretendimet ankimore se gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit ka pasur shkelje të dispozitave ligjore sepse Komisionin përzgjedhës e ka formuar H.N Kryeinspektor i Inspektoratit të Punës, i cili nuk ka pasur autorizim të ushtroj pozitën e kryeinspektorit, me tej ankuesi nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka pretenduar që të aprovohet ankesa e ankuesit si e bazuar në ligj, dhe të obligohet Inspektorati i Punës, që të anulojë konkursin për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Cilësinë e Inspektimeve dhe Standardizimin e Gjobave, dhe i nijeti ta rishpall konkursin.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 20.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Inspektorati i Punës, ndërsa kjo e fundit, më datë 04.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A. Nr. 455/2025 të datës 12.03.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës; Konkursi me numër reference RN00015988, i datës 09.12.2025; emalin e dërguar nga SIMBJ, për A.Th; Njoftimin me numër protokoli 437, i datës 24.02.2025, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm i nxjerr nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës; Kopje e Letërnjoftimit për A.Th; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.03.2025, dërguar përmes emailit nga R.K, për K.S; Përgjigjen në ankesë me numër protokoli 455/2025, e datës 04.04.2025; Vendimi me numër protokoli 617, i datës 24.03.2025, i U.D Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës; Vendimin A. nr.455/2025, të datës 22.04.2025, të Këshillit; Vendimin A.nr.07/2025, të datës 07.03.2025,të Këshillit; Vendimin A. nr.166/2025, të datës 07.03.2025, të Këshillit; Vendimin A. nr. 42/2025, të datës 07.03.2025, të Këshillit; Vendimin A. nr,74/2025, të datës 11.03.2025, të Këshill.

Nga provat e administruara të lëndës rezulton Inspektorati i Punës, më datë 09.12.2024 ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00015988, për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Cilësinë e Inspektimeve dhe Standardizimin e Gjobave", numri i kërkuar një (1) pozitë, Drejtues i Ulët, me afat aplikimi nga data 10.12.2024 deri me datë 08.01.2025.

Tutje, Inspektorati i Punës, me datë 24.02.2025, me numër protokoli 437 ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidatin B.L, është vlerësuar me gjithsejtë 94.2.

Me datën 24.03.2025, përmes vendimit me numër protokoli 617, u.d Drejtori Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, ka anuluar konkursin me numër të referencës RN00015988, për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Cilësinë e Inspektimeve dhe Standardizimin e Gjobave", me arsyetimin së sipas vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilat vendime kanë shpallur jo të ligjshëm vendimin me numër protokoli 2430, të datës 13.09.2024, dhe vendimin me numër protokoli 2734, të datës 11.10.2024, të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, me të cilën janë shpallur procedurat e rekrutimit të cilat janë përshkruar në diapozitivin e këtij vendimi.

Ankuesi A.Th, i pakënaqur me njoftimin e datës 24.03.2025, me numër protokoli 437,lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Cilësinë e Inspektimeve dhe Standardizimin e Gjobave", me datë 12.03.2025, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, kundër njoftimit të datës 24.02.2025, për përzgjedhjen përfundimtarë të kandidatit të suksesshëm për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Cilësinë e Inspektimeve dhe Standardizimin e Gjobave", me pretendimet ankimore se gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit ka pasur shkelje të dispozitave ligjore sepse Komisionin përzgjedhës e ka formuar z, H.N, Kryeinspektor i Inspektoratit të Punës, i cili nuk ka pasur autorizim të ushtroj pozitën e kryeinspektorit, me tej ankuesi nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka pretenduar që të aprovohet ankesa e ankuesit si e bazuar në ligj, të obligohet Inspektorati i Punës, që të anulojë konkursin për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Cilësinë e Inspektimeve dhe Standardizimin e Gjobave, dhe i nijeti ta rishpall konkursin.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se lartë theksuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes vendimit 166/2025 të datës 07.03.2025,vendimit 01/2025 të datës18.02.2025, vendimit 144/2025 të datës 27.02.2025, vendimit 07/2025 të datës 27.02.2025, vendimit 42/2025 të datës 07.03.2025, vendimit 2124/2024 të datës 28.02.2025, dhe vendimit 74/2025 të datës 27.02.2025, ka anuluar procedurat e rekrutimi të zhvilluar nga Inspektorati i Punës me arsyetimin së Kryeinspektori

i Inspektoratit të Punës nuk ka pasur autorizim ligjor që ti ndërmerr veprimet ligjore për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, dhe se duke pasur parasysh se ankesa e ankuesit është ngritur mbi pretendimet ankimore për shkelje ligjore dhe ri shpalljen e procedurës së njëjtë të rekrutimit, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj anekese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.174/2025, të datës 22.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 455/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.Th;
- Njësisë për Burime Njerëzore në Inspektoratin e Punës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së